

URDHËR
Nr. 36, datë 12.5.2015

**PËR KUFIZIMIN E SASIVE TË KARBURANTIT QË GJENDET NË SERBATORËT E
ZAKONSHËM DHE DEPOZITAT E POSAÇME TË AUTOMJETEVE TREGTARE
DHE NË SERBATORËT E LËVIZSHËM TË AUTOMJETEVE PRIVATE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shkronjës “t”, të pikës 3, të nenit 184, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të neneve 207, 208, 209, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 29.12.2014, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit, nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Përfshihet nga detyrimet e importit, karburanti që mbajnë serbatorët e zakonshëm dhe depozitat e posaçme të automjeteve tregtare, vetëm për sasinë deri në 200 litra për automjet dhe për çdo udhëtim.

2. Përfshihet nga detyrimet e importit, karburanti që mbajnë serbatorët e zakonshëm dhe depozitat e posaçme të automjeteve tregtare, që kryejnë transport ndërkombëtar nëpër zonën e tyre kufitare me thellësi maksimale prej 15 km në vijë ajrore, me kusht që udhëtimet të kryhen nga banues të zonës kufitare, vetëm për sasinë deri në 150 litra për automjet dhe për çdo udhëtim.

3. Nuk lejohet përjashtim nga detyrimet e importit për karburantin që mbahet në serbatorë të lëvizshëm, që transportohet nga automjete private dhe motoçikleta që u përkasin banuesve të zonës kufitare.

4. Në rast të konstatimit nga administrata doganore të tejkalimit të sasive të karburantit sipas përcaktimeve në këtë urdhër, ndaj subjektit /individit zbatohen të gjitha detyrimet e importit, sipas nivelit tarifor të zbatueshëm në datën kur ndodhi mosrespektimi. Llojit të mallrave dhe të vlerës doganore të konstatuar ose pranuar prej autoriteteve doganore kompetente në atë datë.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave të saj për zbatimin korrekt të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani